



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T I

Nga procesverbali i mbledhjes së 37-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 26.12.2024, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Shefki Bytyqi, anëtar
3. Gazmend Qerkini, anëtar
4. Shkelzim Olluri, anëtar
5. Albiona Tasholli, anëtare
6. Nexhemdin Lekiqi, anëtar
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Sami Bytyqi, anëtar
9. Fitim Shala, anëtar
10. Xhyzide Rustemi, anëtare
11. Rinor Murati, anëtar
12. Armend Grajqevci, anëtar
13. Gentianë Hoxhaj, anëtare
14. Venhar Agushi, anëtar
15. Xhyla Dedushaj, anëtare
16. Lulzim Rustemi, anëtar
17. Herolind Kozhani, anëtar
18. Ardit Cani, anëtar
19. Arsim Jashari, anëtar
20. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
21. Ganimete Qeriqi, anëtare
22. Alban Salihu, anëtar
23. Fitim Meziu, anëtar
24. Fadil Spahiu, anëtar
25. Fatmir Fetahu, anëtar
26. Shahadije Dragaçina, anëtare
27. Besiana Sylja, anëtare
28. Enver Kryeziu, anëtar
29. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i komunës
2. Diamant Bytyqi, Nënkyetar i komunës
3. Lulzim Qerimi, Nënkyetar i komunës
4. Latif Ramadani, DBF
5. Shkelzen Hajdini, DSHMS
6. Elmaze Behluli, DA
7. Sead Aliu, DI
8. Valon Pacolli, DEZH
9. Rexhep Rexhepi, DBP
10. Rasim Hasani, DKA
11. Safete Amerllahu, DGJK
12. Burim Rustemi, DSHPMSh
13. Imri Semetishti, DUPMM
14. Anila Reqica-Llugiqi, DKRS
15. Përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit, tha se uroj që jeni mirë, po ashtu tha se ju uroj festat e fund vitit duke ju dëshiruar shëndet dhe suksese. Në vazhdim tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë me kohë, pastaj lexoi rendin e ditës të propozuar:

REND DITE

1. **Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 35-të e Kuvendit**
2. **Informatë e Këshillit Komunal Koordinues në mbrojtje të viktimave të dhunës në baza gjinore.**
3. **Propozim Rregullore për Transparencën në Komunën e Lipjanit.**
4. **Propozim Rregullore për organizimin e brendshëm, sistematizimin dhe klasifikimin e vendeve të punës në Komunën e Lipjanit.**
5. **Propozim Vendim për formimin e Komisionit përzgjedhës Ad.hoc për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Lipjanit.**
6. **Propozim Vendim për miratimin e Planit orientues të punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për vitin 2025.**

Pastaj kryesuesi tha ashtu siç ju kemi njoftuar edhe me herët me kërkesë të ekzekutivit dhe me rekomandim të KPF-së, do të tërhiqet nga rendi i ditës pika e 4 (katërt) e rendit të ditës, 4. Propozim Rregullore për organizimin e brendshëm, sistematizimin dhe klasifikimin e

vendeve të punës në Komunën e Lipjanit. Ndërsa ne vend të pikës 4 kalon pika e 5-të dhe kështu me radhë

Po ashtu me propozim të ekzekutivit dhe me rekomandim të KPF-së, do të kemi edhe 2(dy) pika shtesë për rend të ditës:

6. Propozim vendim për miratimin e gjuhës turke si gjuhë tradicionale në komunën e Lipjanit –Qytezën e Janjevës.

7. Propozim vendim për anulimin e vendimit 15Nr.020/04-59397, për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e proceduarve për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme-lokaleve afariste në ZK Magurë, i datës, 29.11.2024, i cili është kthyer negativ pas kalimit të afateve ligjore.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se nuk e di gjatë këtij mandati a ka pas ndonjë mbledhje që nuk kemi shtuar pika për rend të ditës nga ana e ekzekutivit. Kjo është bere një shprehje jo e mire dhe kjo po na qet para një akti që ne nuk po dimë as çka kemi me votuar , pasi që nuk po kemi mundësi me i shikuar dhe analizuar materialet. Për mu shtua pikat e rendit të ditës janë disa kritere dhe duhet të respektohen. E para pikat që shtohen duhet të jen urgjente dhe me interes të përgjithshëm publik, e dyta duhet të jene pika që kuvendi në afatin ligjor duhet ti shqyrtoj. Prandaj me që këto pika kanë kaluar filtrin edhe në KPF, kësaj radhe le të shkon kështu, mirëpo kërkoj nga ekzekutivi herëve të tjera mos të na ngarkoj me pika që nuk janë urgjente le të presin deri në seancat e ardhshme.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se zakonisht pika shtese që janë ardhë për rend të ditës kanë qen pika që nuk kanë pas shume material, kur ka pas pika voluminozë nuk i kam shtie. Unë piken për komisionin e kam shtuar vet edhe pse na e kemi publikuar në faqe ata na kanë kthyer në rishqyrtim.

Kryesuesi i kuvendit hodhi në votim sa pari propozimin që pika e 4 Propozim Rregullore për organizimin e brendshëm, sistematizimin dhe klasifikimin e vendeve të punës në Komunën e Lipjanit të hiqet nga rendi i ditës dhe pas votimit u konstatua se me 25 vota për, u aprovua propozimi.

Pastaj Kryesuesi i kuvendit hodhi në votim propozimin që të shtohen dy pika shtesë

6. Propozim vendim për miratimin e gjuhës turke si gjuhë tradicionale në komunën e Lipjanit –Qytezën e Janjevës.

7. Propozim vendim për anulimin e vendimit 15Nr.020/04-59397, për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e proceduarve për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme-lokaleve afariste në ZK Magurë, i datës, 29.11.2024 Pas votimit u konstatua se me 25 vota për, u aprovua propozimi.

Pastaj Kryesuesi i kuvendit hodhi në votim rendin e ditës se propozuar më lartë ku tha se do të tërhiqet nga rendi i ditës pika e 4 (katërt) e rendit të ditës, 4. Propozim Rregullore për organizimin e brendshëm, sistematizimin dhe klasifikimin e vendeve të punës në Komunën e Lipjanit. Ndërsa ne vend të pikës 4 kalon pika e 5-të dhe kështu me radhë dhe pas votimit u konstatua se me 25 vota për, u aprovua rendi i ditës.

Pastaj u kalua në pyetjet e anëtarëve të kuvendit?

Arsim Jashari, tha se pari në emër të grupit të PDK-së, ju uroj festat e fund vitit, duke ju dëshiruar shëndet dhe suksese. Pastaj tha se kam disa pyetje dhe kërkesa, e para për drejtorinë e infrastrukturës, si ka mundësi të lihet në këtë gjendje një investim në një park në fshatin Llugaxhi, ku i keni dhe fotot që ua kam sjellë. E dyta, që 3 vite po diskutoj për investimet e dobëta që po bëhen në disa fshatra. Këtu duhet me marr dikush përgjegjësi. Për drejtorinë e shërbimeve publike që disa vite kam bërë kërkesë për vendosjen e policëve të shtrirë afër shkollave dhe ende nuk janë vendosur çfarë rreziku janë nxënësit të shkollave fillore në Banullë nga vozitësit e shpejtë të veturave. Dhe për fund e kam një kërkesë që mos të ushtrohet presion ndaj institucioneve për tju votuar, votimi duhet të bazohet në vullnet të lirë e jo në presion.

Besiana Sylja, tha se unë i kam dy kërkesa e para, shtrati i lumit në fshatin Smaullueshe ka mbetur në gjysmë të punimeve që nga viti i kaluar. A ka ndërmarr komuna masa konkrete për ta rregulluar këtë lum, po ashtu në të njëjtin vend është dëmtuar edhe gypi i kanalizimit gjatë punimeve, ku ka mbetur ky proces pse askush nuk është marr me atë pjesë. E dyta banorët e fshatit Gllavicë janë në hall me rrugën Avdirrahmon Gashi, rrugë që e lidh këtë fshat me fshatin Gadime, ku këtu po rrezikohen fëmijët por kemi edhe disa raste kur veturat janë hyrë në objektet shtëpiake. Në atë rrugë nuk ka asnjë shenjë njoftuese.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se kam disa çështje për ti ngritur, para disa muajve shtatorja e heroit "Ismail Lumes" është dëmtuar nga persona të pa përgjegjshëm dhe nuk ka pas ndonjë intervenim nga ana e ekzekutivit. Kërkoja që me u mirëmbajt ai investim. Në fshatin Poturovc është vendosur nxemja mirëpo nuk po funksionon dhe aty nuk ka kushte për tu zhvilluar mësimi. Tjetra e kemi par që është publikuar konkursi për bursa, unë dua të bëj një kronologji viteve të kaluara kohës kur janë publikuar konkursi për bursa, ku në vitin 2020 është publikuar në muajin tetor, po ashtu edhe në vitin 2021, ndërsa në vitin 2022 dhe 2023 në muajin shtator ndërsa në vitin 2024 në muajin dhjetor. Kam një pyetje konkrete a ka të bëjë shtyrja e afatit për burës me zgjedhjet që pritet të mbahen me 9 shkurt, nëse po kjo është shumë e ulët.

Rasim Hasani, tha se thesari egezekuton shpesh lende për shkak te kontratës kolektive dhe ne nuk kemi mujt me i shpall për shkak se i ka marr thesari mjete qe janë caktuar për bursa.

Ganimete Qeriqi, tha se institucionet e komunës kane qen ne homazhe në Krojmir për 3 Dëshmorët e kombit, mirëpo dëshmori Bashkim Krasniqi nga Zllakuqani nuk është përjetësuar me asnjë shenjë asnjë fjale asnjë pllake asnjë poezi për të. Ai ka qenë një luftëtar shume i devotshëm dhe ju si institucion keni qëndruar te heshtur ndaj këtij dëshmori. Si qëndron puna me ndërmarrjen banesore në Lipjan a ka ose jo si qëndron puna ne Lipjan.

Ardit Cani, tha se kam disa çështje për ti diskutuar, e para a është nënshkruar kontrata për mirëmbajtjen e ndriçimit publik pasi qe janë prishur shume drita, dhe a i mbikëqyr dikush këto drita sepse po prishen shpesh. Kërkesa tjetër ka te bëjë me drejtorinë e shërbimeve publike, për pastrimin e grykës se Baines pasi qe aty është krijuar një deponi ilegale ku sjellin mbeturina edhe nga vendet e tjera ne atë vend. Po ashtu kamë kërkuar te vendosen edhe shenja qe ndalojnë hedhjen e mbeturinave ne atë pjesë mirëpo deri tani nuk janë vendosur. Po ashtu pajtohna me parafolësin Arsimin, për vendosjen e pengesave ne rrugë sidomos afër shkollave ku po rrezikohen nxënësit.

Egzona Bytyqi, tha se pari ndihem mire qe dy kërkesa te mijat te parashtruara ne mbledhjet e kaluara janë marr parasysh nga ana ekzekutivit dhe janë kryer me prioritetet e para ka te bej me renovimin e shkollës ne fshatin Qylagë dhe e dyta shkolla Haredin Bjarami, në Magure është pajisur me dy pajisje moderne për pastrim. Por shkolla ne Qylage ka nevojë edhe për të investuar për korrika dhe tavolina te reja. Çështja tjetër për DKRS-në dhe Shëndetësinë qe me i pajis ose klubet sportive ose ambulancat me defiblator automatik, apo mobil këtë e them nga rasti i fundit tragjik ne Lipjan. Çështja tjetër ndihem keq si po behën virale videot për me qen sa me afër substancave narkotike për mi përdor ato. E fundit, ka te beje me zyrtaret komunal qe pajtohemi te gjithë për vëllimin e madh te punës qe e kane përgjegjësitë qe i kane. Propozimi im është ky edhe pse tash pak i vonë , propozoj qe për vitin e ardhshëm për zyrtaret komunal te planifikohet dhe paga e 13-të, pasi qe Prishtina këtë qe dy vite po e praktikon.

Lulzim Rrustemi, tha se unë e kam një kërkesë dhe një shqetësim apo vërejte për punën e kuvendit, na jemi ne fund te mandatit kemi bere një pune te mire te madhe ne shërbim te qytetarëve. Ne kemi pas disa kërkesa për pika te veçanta te rendit te ditës. E para kërkesë për pike te veçantë për gjendjen e arsimit ne komunën

e Lipjanit, për rregulloren për bursa për ndryshim plotësim. Kërkesë për drejtoratin e bujqësie të sjellën të gjitha pronat të cilat nuk janë në menaxhim të komunës e të cilat duhet të ju hapen fermerëve për punë. Kjo është njëra nga dobësitë që e ka përcjelle kuvendi. Kërkesa ime e vetme është të anulohet konkursi për bursa, për shkak se nuk është ndryshur dhe plotësuar rregullorja dhe me këtë studentet që studiojnë jashtë nuk kanë të drejtë me aplikuar për burse.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se ne e kemi një plan të punës të cilin e kemi zbatuar me përgjegjësi, lista e pronave bujqësore është e publikuar në faqe të komunës.

Shahadije Dragaqina, tha se edhe unë pajtohna me parafolësen rreth konkursit të bursave, ku i shikova konkurset e shpallura me herët e pasth që vitet e kaluara janë shpallur në muajin shtator ose tetor dhe kjo po ma jep dyshimin se po bëhet për shkak të fushatës dhe në kohë të zgjedhjeve. Ndërsa kërkesa e dytë ka të bëjë për një rrugë që shkon të shkolla e Janjevës pse ka mbet ajo rrugice pa u asfaltuar a po bëhet për shkak se nuk janë përkrahës të juve. Dhe e fundit mbledhja e jashtëzakonshme e thirrur nga partia juaj është publikuar në faqen e komunës në facebook, ndërsa mbledhjet e tjera deri tani jo.

Alban Salihu, tha se për QKMF në Lipjan kemi dëgjuar për mungesë të pediatrie ndërsa anën tjetër po hapen konkurse për specializim, por nuk ka pas ndonjë kërkesë nga drejtoria e shëndetësisë për specializant të pediatrie. Kam pyetje për drejtorinë e shëndetësisë si do ta zgjidhni këtë çështje? Çështja tjetër në shkollën fillore “Vëllëzrit Frasheri në Lipjan para disa viteve është ndërtuar një aneks dua të dije nëse është funksional dhe është duke vazhduar mësimi. Për fund e pasth në rrjetet sociale e pasth kandidatet për deputet nga ana juaj dhe e pashe që e kishin ashpërsuar gjuhen e kjo nuk ju shkon si LDK.

Rinor Murati, tha se kam disa çështje për ti adresuar, e para sa i përket barnatoreve kujdestare në konsultim me to propozoj që secila prej tyre ta ketë edhe pjesën shitëse apo shallterin në mënyrë që barnatoret që janë kujdestare të shesin përmes shallterit. Kërkesë nga banoret e fshatit Brus për rrugën që qon për Peshter pasi që gjatë dimrit po jetë pa u pastruar.

Xhyla Dedushaj-Rexhepi, tha se pasi që kohën e fundit po kemi problem me energji elektrike kam marr disa shqetësime të banorëve të fshatrave Ruf, Slllovi Shalë, pasi që çerdhet nuk janë duke funksionuar për këtë arsye. A ka gjet komuna ndonjë zgjedhje për ta eliminuar këtë problem.

Fadil Sopa, tha se unë kam kërkesë për kryetarin që me shku në pushim deri me 10 shkurt, pasi që gjdo pune që po e kryen po mendojnë që për fushatë po e bene.

Diamant Bytyqi, nënkryetar i komunës tha se do të mundohem t'ju përgjigjem pyetjeve që u ngritën, parku në Lugaxhi është ndërtuar që disa vetën ka nevojë të mirëmbahet. Në bujari pengesat në trotuar mund të rregullohen, për vendosjen e policave të shtirë po kemi probleme sepse disa po bëjnë kërkesa mi vendos pastaj disa të tjerë me i larguar. Në nuk bëjmë presion për votë. Kanalizimi në Smallushe është rregulluar por nëse ka probleme në do të intervenojmë prapë. Shtrati i lumit edhe ai do të rregullohet. Në Gllavice do të rregullohen ose sinjalizimi që tregon që është kthënë ose pengesat në rrugë. Shtatorja e heroit "Ismail Luma", i është dëmtuar një pjesë por do ta rregullojmë atë pjesë, mirëpo tani mu kujtua që ju nuk i patet votuar shtatore të heronjve ndërsa tash po e ngritni çështjen e dëmtimit të një pjesë shumë të vogël. Në Poturovc kemi pas telashe në shkollë dhe disa fshatra tjera por është rregulluar. Sa i përket rregullores nuk kemi muajt me ndryshuar pasi që nuk kemi gjet ndonjë të ngjashme për me i përfshi studentet që studiojnë jashtë, sa i përket konkursit për bursa e shpjegoj drejtori më herët. Ndërmarrje publike nuk kemi, pasi që ende nuk kemi marr asnjë konfirmim nga ministria edhe pse e kemi votuar që disa vite në kuvend. Sa i përket ndriçimit publik ka qen kontrata në OSHP dhe shumë shpejtë do të fillojë, po ashtu edhe pastrimi i deponive është bërë disa here dhe do të behën prapë. Sa i përket shkollës së Qylages është bërë renovimi i saj, pra do të bije edhe korrikat dhe bankat e reja. Por edhe kërkesës për defilibitor kërkesë më vend dhe kjo do të ishte mirë me qen obligative për klube sportive që ti kenë këto paisje. Zyrtaret komunal rroga e 13 propozim i mirë, mirëpo kjo është e pa mundur, pasi që është një shumë e pa përballueshme.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se ky zhargoni i komunikimit sa here diskutojmë se ju nuk e keni votuar buxhetin e sidomos kur është fjala për heronjtë e popullit, nga ana juaj nuk është aspak etike, sepse PDK-ja, në gjenezën e saj e ka UÇK-në. Nëse nuk e ke ditë në grupin e PDK-së, në i kemi 3 veteran. Dhe këto këshillat e juaj që në nuk e kemi të drejt me fol për lapidarët janë shumë të ulëta. E di që jeni të përkushtuar për ta riparuar demin por jo me shit moral se sa na jemi për apo kundër UÇK-së, na kemi qen kundër buxhetit që i ka instrumentatizuar heronjtë e kombit.

Diamant Bytyqi, nënkryetar i komunës tha se në kemi respekt për veteranet që i kemi këtu por edhe për të gjithë dëshmorët dhe martirët e luftës dhe për kategoritë e dal nga lufta, respekt maksimal për ta, por pa buxhet nuk kishin muajt me u realizuar ato shtatore.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha ju njoftoj qe për shkak te problemit me energji elektrike ka pas ndërprerje te pa qëllimshme te seancës live te disa folës. Te faqja e komunës para mbledhjes se jashtëzakonshme kemi filluar publikimin e festave te kuvendit. Ju ftoj te gjithëve ne hapjen e projektit gjigant te nënkalimit ne ora 17:00 dhe nesër ne ora 11 e koktejin e fundit te organizuar nga kryetari i komunës.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se te gjitha pajisjet e nevojshme për shëndetësi do te blehen QKMF, por edhe ky lloj i defibulatorit qe ju kërkua. Shërbimi ne shallter ne farmaci pajtohem. Pronat publike jane te publikuara por edhe pronat e uzurpuara. Debati për arsim është mbajt dhe do te jete prape siç e keni pas ne raport te kryetarit. Ne i kemi dy mjek në specializim dhe presim te na kthen. 90% e rrugëve janë shtruar ne komune e Lipjanit dhe nuk ka ndarje partiake. Na po kemi problem me nxemje për shkak te energjisë elektrike te dobët. Unë se kam njet me shkua ne pushim unë do te vazhdoj me projekte për te mirën e qytetarëve te komunes se Lipjanit. Sa i përket bursave, është mire me shikuar tërësinë, a është me mirë me i dhen 400 bursa, a me e rëndësishme me kthye vëmendje qe një kategori qe po studiojnë jashtë qe i kane punën me mire financiarisht. Është mire me shikuar se si është rritur numri i bursave po thuaj çdo vit. Ndërsa dikur nuk është dhënë asnjë cent për këtë kategori. Nëse nuk e shihni një shtatore kaq te madhe ose nuk i shihni disa shatorë duke e përfshirë edhe atë te Adem Jasharit ne Lipjan e ndërsa e shihni një defekt kaq te vogël.

Lulzim Rrustemi, tha se nuk e kam kërkuar vetëm publikimin e listës se pronave bujqësore, por kam kërkuar qe te vie ne kuvend dhe te epën prape ne shfrytëzim, sepse ka shume prona qe i kane njerëz te pa autorizuar. E dyta për bursa nuk janë shume bursistë, por nëse komuna nuk ka vizion qe njerëzit qe studiojnë jashtë shtetit te jene kuadër për brena kjo është dobësi e juaja. Studentet duhet te jene te barabartë. Kjo është gabim qe janë hequr nga rregullorja e bursave.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se unë nuk i kam ndar asnjëherë as qytetarët as ata qe studiojnë jashtë apo brenda dhe nuk beje asnjëherë ndarje te tilla, është mire me poentuar. Edhe vitin e kaluar kane marr bursa ata qe mu kane drejtuar me kërkesë dhe unë ju kam ndihmuar me subvencione. Dhe ju ndihmoj prape ju ftoj publikisht ata qe studiojnë jashtë le të aplikojnë dhe unë do te ju ndihmoj. Pronat bujqësore publike janë publike dhe mund te jepet ato qe janë te nevojshme.

Lulzim Rrustemi, tha pse me i ftuar kryetari ne zyre studentet për te aplikuar ne burse.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se nuk tha kryetari me i ftuar ne zyre, por tha i ftoj me aplikuar përmes zyrës se kryetarit dhe ne i ndihmojmë.

Ekstraktin nga mbledhja e 35 të, e Kuvendit.

Lidhur me këtë pike kryesuesi pyeti a ka vërejte apo plotësime rreth ekstraktit nga mbledhja e 35-të.

Me qe nuk pati vërejte as plotësime Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 35-të e Kuvendit, pas votimit konstatoi se Kuvendi me, 29 vota për aprovoi Ekstraktin nga mbledhja e 35 të, e Kuvendit.

Shtesë: Ekstrakti

II

Informatë e Këshillit Komunal Koordinues në mbrojtje të viktimave të dhunës në baza gjinore.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi , Daut Azemi, ia dha fjalën Fjolla Ibrahimit nga QPS-ja, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga informata

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se ju falënderoj për informatën është një teme qe na prek te gjithëve dhe duhet qe ta mbështesim. Unë falënderojë dhe grupin e PDK-së, për kontributin. Unë kam një pyetje ne vitin 2024, ka rritje te rasteve te dhunës. Dhe e kam një kërkesë, ne mitingje politike vajzat e QPS-së, nuk është mire me postuar foto te mitingjeve politike. Sepse dihet rëndësia qe e ka QPS-ja.

Shahadije Dragaçina, tha se unë edhe ne seancën e kaluar kam kërkuar te kemi një informate te tille duke marr parasysh se sa e ndjeshme është kjo temë. Ne raportë pash qe ka rritje te rasteve nga viti ne vit. Rastet e raportimit kan ndikuar ne vetëdisim me te larte, por kjo nuk duhet te mbetet vetëm ne 16 dite por te vazhdoj edhe me tutje dhe mos te ketë kur raste te dhunës ne familje. Një analize e mirëfillte ne detaje ne raport do të ishte me e nevojshme. Ne qendrën për te cilën kemi ndarë ne mjete kuvendi komunal, a ka ndonjë grua qe është duke u trajtuar aty.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se ne raport po shihen qe është përfshirë puna prej vitit 2016 e punës se këshillit. Ne mbledhjen e kaluar ka qen një vërejtje qe na ja kemi adresuar këshillit si kuvend rreth spotit, ku aty është dashtë te paktën me qen kryesuesi i kuvendit qe me përfaqësuar kuvendin. Vërejta ka qen për te gjithë këshillin jo për juve dhe po me vjen mire qe keni reflektuar.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se edhe vitin e kaluar ne e kemi pas ne kuvend informatën.

Rinor Murati, tha se e falënderoj për informatën këshillin, nëse e krahasojmë me vitin e kaluar shihet qe kemi rritje për një rast. Kam një pyetje sa i përket viktimave te strehuara, qe janë 9 çka ndodh me raste e tjera a strehohen ato.

Gaimete Qeriqi, tha se është një raport i mirë nga ana e këshillit, por nëse kritikoheni nuk bën me u dëshpëruar sepse gabimet mund te përmirësohen.

Egzona Bytyqi, tha se unë kam pas fjale te mira për punën e këshillit dhe QPS-në. Uroj qe Lipjani te mos ketë fare rate qe kane te bëjnë me dhunën.

Bashkim Budakova, tha se me gjithë këto trajnime, prap nuk kemi renje te dhunës ne familje cili është efekti i këtyre trajnimeve.

Fjolla Ibrahim, tha se ju falënderoj për kontributin tuaj qoftë përmes debatit, këshillave, kritikes, ne jemi njerëz mundemi me bo edhe gabime. Numrin e rasteve është me shume te gratë dhe te fëmijët. Ka filluar te këtë me shume vetëdijsim te qytetarëve sa i përket rasteve. Ne jemi 39 anëtarët ne këshill. Jo te gjitha viktimat vendosen ne strehimore, sepse jo çdo viktime pranon te strehohen ne strehimore. Kemi një rast te rritjes këtë vit me shume.

Meqë diskutime tjera nuk pati u kalua ne piken ne vazhdim.

III

Propozim Rregullore për transparencën në Komunën e Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Anila Reqica-Llugiqi, e cila, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Xhyla Dedushaj-Rexhepi, tha se një rregullore shume e mirë për tarsneprecen dhe llogaridhënien ne komune e Lipjanit, kur përcakton rregulla për përfshirjen e qytetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve te interesit ne proceset vendimmarrëse duke

i dhen prioritet qeverisjes se hapur dhe bashkëpunuese. Komuna e Lipjanit është përfituese e grupit te performances qe disa vite . Ky sukses dëshmon përkushtimin e komunës për ti ndjekur praktikat më te mira te qeverisjes dhe për te garantuar rezultate konkrete ne formimin e shërbimeve për qytetaret. Kjo rregullore ka kaluar ne konsultime publike.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se unë jam shumë skeptike qe kjo rregullore do te zbatohet ndonjë here. Sa i përket transparencës se punës se kuvendit ka pas përjashtime siç është te neni i 5 i kësaj rregullore te informimi, asnjëherë zyra e informimit nuk i ka publikuar ftesat ne rrjetet sociale. Pra qytetaret nuk janë informuar asnjëherë përmes rrjeteve sociale për mbledhje te kuvendit apo te komiteteve. Kjo ka filluar ne mbledhjen e jashtëzakonshme te cilën e ka thirrur LDK-ja. Po ashtu asnjëherë nuk pasqyrohet asnjë diskutim e anëtareve te kuvendit ne faqen e komunës. Ne mbledhjen e jashtëzakonshme nuk është pasqyrua diskutimi i asnjë anetari te kuvendit vetëm iniciuesit te kësaj mbledhje Armendit dhe me këtë po behet diskriminim. Ne do te abstenojmë në votim për, këtë rregullore.

Daut Azemi,kryesues i kuvendit tha se ftesat e kuvendit para mbledhjes se jashtëzakonshme kane filluar te publikohen ne rrjete sociale . E dyta ligji nuk na obligon me i publikuar ne rrjete sociale ndërsa me këtë rregullore po, dhe në si komune për transparencë kemi nxënë vendin e pare disa here. Ne kur ka pas problem me faqe kemi thënë mund te publikojmë ne rrjete sociale kane thënë jo.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se zyra e informimit prej mbledhjes se fundit te kuvendit te jashtëzakonshmes ka filluar te publikoj ne rrjete sociale, me këtë e ka publikuar vetëm fjalimin e Armendit si iniciues te kësaj kërkesë ndërsa te diskutuesve te tjerë jo me këtë është bere diskriminim.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se ju gjate diskutimit po e thoni te pa vërtetën, komuna para seancës se jashtëzakonshme ka filluar me publikuar ftesën e kuvendit.

Armend Grajqevci, tha se nuk është qe i kam përcjell shume postimet ne faqe kohen e fundit, mirëpo fjalimi im ka qene pjese informuese për juve dhe për qytetaret e komunës se Lipjanit.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha ne nëse ti nuk i përcjell faqen e komunës unë e përcjelli. E dyta na edhe ne te kaluarën kemi mbajti seanca por nuk e kane publikuar dhe me këtë po behet diskriminim.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 15 vota për, 12 abstenime, aprovoi propozimin

IV

Propozim Vendim për formimin e Komisionit përzgjedhës Ad.hoc për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rasim Hasanit, drejtori i DKA-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 147 vota për, 11 abstenim aprovoi propozimin

V

Propozim Vendim për miratimin e Planit orientues të punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për vitin 2025

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit. Pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për, aprovoi propozimin

VI

Propozim vendim për miratimin e gjuhës turke si gjuhë tradicionale në komunën e Lipjanit –Qytezën e Janjevës.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Diamant Bytyqit, nënkryetar i komunës i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se unë edhe me herët kërkoja qe mos te hyjnë këto pika nëse nuk janë me urgjencë, sepse kjo pike është shume e rëndësishme mirëpo kjo pike si është fut në kuvend i ka shkel te gjitha procedurat, i ka shkel te gjitha ligjet qe është bazuar. E para përmend udhëzimi administrativ për përdorimin e gjuhëve, ne e kemi majte mbledhjen e komitetit dhe nuk na ka ardh fare ne komitetin për komunitete edhe pse kërkesa ka ardh shumë ma herët. Po ashtu është shkele dhe ligji për gjuhe zyrtare. Unë nuk kam mujt askund me gjet ne ligj qe kemi te drejte me bere këtë. Kjo është ne kundërshtim me aktet ligjore te bazuara. Dhe nuk mundet vetëm një fshat me përdor këtë gjuhe. Pse kjo urgjence, për këtë duhet një debat me i gjere, me u shqyrtuar edhe ne komitetit për komunitete.

Diamnt Bytyqi, nënkryetar i komunës, tha se unë i uroj mirëseardhje deputetit te kuvendit te Kosovës Enis Kervan, dhe kryesuesit te komitetit për komunitete Skender Bikliqi. Ky propozim e ka kaluar edhe filtrin e KPF-së. E kemi proceduar si pike shtese, ne nuk e kemi si gjuhe ne përdorim zyrtar nuk obligohet komuna me i përkthyer dokumente sepse ne i kemi dy gjuhe zyrtare shqipe dhe serbe. Ne tu e pa rëndësinë e qytezës se Janjeves e kemi propozuar si gjuhe tradicionale ne përdorim zyrtar. Kërkoj nga ana juaj qe ta votoni, pastaj kjo ta merr edhe vlerësimin nga MAPL-ja.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se ne nëse dojmë te bëjmë gjuhe tradicionale po i diskriminojmë edhe komunitetet e tjera si kroat boshnjak dhe te tjera, pse nuk po e bëjmë një vendim për gjuhe tradicionale për te gjitha komunitetet qe jetojnë ne komunën e Lipjanit . Eshë dashtë një debat me i gjere me u përfshiu dhe komuniteti për komunitete.

Diamnt Bytyqi, nënkryetar i komunës, na e kemi pas një takim me komisionin e kuvendit te Kosovës dhe aty ka lind kjo ide për gjuhen turke, nëse ka kërkesa edhe nga komunitetet tjera ne do ti sjellim ne kuvend.

Arsim Jashari, tha se ne e mbështesim atë qe e tha kolegëja jone merpo ne aspektin proceduaral eshët gabim. Çfarë efekti ka ky vendim nëse votojmë. E para na me ligj e kemi fshat jo qytezë, ne po krijojna precedent pa baze ligjore. Komuniteti e mbron gjuhen.

Alban Salihu, tha se i njëjti debat eshët zhvilluar edhe ne KPF, ka paqartësi si çështje. Ne për shkak te raporteve te mira qe kemi me qytetaret e Janjevs, do te votojmë pro.

Gentianë-Hoxhaj, tha se ne emër te grupit te LDK-së, e mbështesim këtë propozim vendim.

Daimant Bytyqi, tha ne emër te komunitetit turk ju falënderoj për votimin e miratimit e gjuhës turke si gjuhë tradicionale në komunën e Lipjanit –Qytezën e Janjevës.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit. Pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 vota për, aprovoi propozimin

VII

Propozim vendim për anulimin e vendimit 15Nr.020/04-59397, për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e proceduarve për dhënien ne shfrytëzim afatshkurtër te pronave te paluajtshme-lokaleve afariste në ZK Magurë, i datës, 29.11.2024

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha duhet me pas kujdes me qeto vendime qe po na kthehen prapë pasi qe po dalim keq edhe ne perefomance. Është mire me i përgatitë mire dhe mos me na u kthyer pasi qe ne vitin 2024 shume vendime janë kthyer negativ.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit deri me tani nuk e kemi asnjë vendim te pa rishqyrtuar

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit. Pas votimit konstatoi se Kuvendi me 24 vota për aprovoi propozimin

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 13:10.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi